



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 82-të të mbajtur më 14.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi me numër 12-4539 të datës 05.05.2022, **HIDHET POSHT.**

Raporti t'i përcillet Drejtorisë së Policisë Financiare dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për veprime kompetente.

Lënda me numër 12-4539 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi të publikohet në formë të depersonalizuar në ven faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Lënda me numër 12-4539 të datës 05.05.2022 është formuar në bazë të denoncimit të dorëzuar nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim kanë të bëjnë me dyshime për sjellje të pakujdesshme dhe keqpërdorim të autoritetit dhe detyrës zyrtare të personit zyrtar ///, sekretar shtetërorë ///, ///, dhe në lidhje me zhvillimin e tenderëve dhe përzgjedhjen e ofertuesve më të favorshëm të personave të tyre të afërt dhe të njohur. KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit është dorëzuar edhe një shpallje publike në të cilën janë paraqitur më në detaje dyshimet.

Pas këqyrjes së përmbajtjes së denoncimit dhe provave të dorëzuara, KSHPK-ja konstatoi se organet kompetente të autorizuara për të hetuar dyshimet në denoncim janë Administrata e Policisë Financiare dhe Ministria e Punëve të Brendshme, për të cilat KSHPK-ja duhet të përcjellë denoncimin me bashkëngjitje autoriteteve për veprime kompetente.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:

- Arkivi i KSHPK-së
- Drejtoria e policisë financiare
- Ministria e punëve të mbrendshme

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија

Адреса: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut

email: contact@dksk.org.mk

тел/tel: +389 2 3248 930

<https://www.dksk.mk>

Përgatiti: Mr. D.D
Miratoi: Mr. V.G

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar,
Katica Nikolovska**

